



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Mr. Ardiana Bunjaku

Kryetare e Këshillit Drejtues të UP

Nr. Prot.: 4/242
Datë: 15/11/2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" e shqyrtoi kërkesën me nr. prot: 4/607 dt: 5.11.2018, të parashtruar nga prof. dr. Hajrip Mehmeti, prodekan për çështje financiare në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, në mbledhjen e mbajtur më 15.11.2018, mori këtë:

V E N D I M


- I. APROVOHET kërkesa me nr. prot: 4/607 dt: 5.11.2018 e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, për ndarjen e mjeteve shtesë në vlerë prej 1500.00 euro, për mbulimin e padokut (shëtitore) në fermën eksperimentale-didaktike, në kuadër të së cilës gjenden bagëtitë e imëta (delet dhe dhitë).
- II. Mbulimi i padokut (shëtitores) në fermën e lartcekur bëhet me qëllim të mbrojtjes së bagëtive të imëta nga të reshurat atmosferike dhe të ftohtit në sezonin dimëror si dhe nga vapa kur pritet të jetë në sezonin veror.
- III. Obligohet shërbimi i financave të Universitetit të Prishtinës që konform dispozitave ligjore dhe pas punëve të realizuara në rregullimin e padokut, të bëjë ndarjen e mjeteve shtesë deri në vlerë 1500.00 euro, përkatësisht për mbulimin e padokut sipas kërkesës në fjalë.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe kërkesa me nr. prot: 4/607 dt: 5.11.2018.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, pasi e shqyrtoi kërkesën e prot: 4/607 dt: 5.11.2018, të parashtruar nga prof. dr. Hajrip Mehmeti, prodekan për çështje financiare në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, për ndarjen e mjeteve shtesë në vlerë prej 1500.00 euro, për mbulimin e padokut (shëtitore) në fermën eksperimentale-didaktike, në kuadër të së cilës gjenden bagëtitë e imëta (delet dhe dhitë), me qëllim të mbrojtjes së tyre nga të reshurat atmosferike. Duke pasur parasysh se në bazë të vendimit 1/419 dt: 17.5.2018, janë destinuar mjete në vlerë 3190.00 euro nga buxheti i FBV-së por pas shpalljes së tenderit është ofruar vetëm një operues dhe atë në vlerë 4500.00. KD-ja e konsideroi të arsyeshme kërkesën e FBV-së, pasi që mjetet e planifikuara nga kjo njësi nuk kanë qenë të mjaftueshme, prandaj mbi këtë bazë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Shërbimit financiar të FAB-së;
4. Shërbimit financiar të UP-së;
5. Zyrës Ligjore të UP-së;
6. Ueb faqe të UP-së.

Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Ardiana Bunjaku – kryesuese

